

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Meqenëse jemi në këtë tematikë diskutimi, le të hyjmë drejtpërsëdrejti dhe të qajmë së bashku hallet e qytetarëve, ato që i preokupojnë më shumë. Cili është preokupacioni kryesor i tyre? Preokupacioni kryesor është që ata nuk e ndiejnë dhe nuk e kanë pranë shtetin; ata i paguajnë taksat e tyre, por gjithmonë janë të vetmuar përballë problemeve të mëdha. Në radhë të parë ata përballen me çmime të jashtëzakonshme për të cilat të gjithë ngrenë duart, nga Kryeministri i pari. Ndihma ose mbështetja për ta nuk ekziston, ndërkohë që pagesat, të cilat u takojnë atyre, që ne me shumë të drejtë i quajmë oligarkë, pra përfituesve dhe klientëve më të fortë të qeverisë, janë të rregullta, por edhe pezullimet e përkohshme të pandemisë janë vetëm të përkohshme pasi paguhen rregullisht. Pra, nuk ka amortizatorë për çmimet e bukës dhe për produktet bazike të shportës, por ka gjithmonë për oligarkët dhe këtë të gjithë duhet ta mbajnë mirë në mend. Gjithashtu, shikojnë një shtet për të cilin imazhet janë shumë të qarta përpara syve të tyre, shumë të egër me qytetarin e thjeshtë, por njëkohësisht i preokupuar që kur policia sillet egërsisht, kujdeset me shumë vëmendje të mbrojtë dhe të mbulojë bëmat e saj që gjithmonë qytetari të mbetet mënjanë, i rrezikuar, i poshtëruar, i rrahur dhe në fund i mashtruar, pra del që ai është fajtori. Pra, ata nuk e kanë shtetin me vete, por kanë një shtet armik të vetes. Ndërkohë, le të vijmë te një problem shumë i madh, te drejtësia. Unë dëgjoj vazhdimisht këtu dhe ndiej shumë keqardhje e pështirosje njëherazi kur dëgjoj që thonë: “Votoni vetingun, votoni vetingun! Kemi hartën e madhe gjyqësore. Ja dy gjërat e mëdha që e zgjidhin reformën në drejtësi.”. Po pse tallen me qytetarin? Përse gënjejnë? Po si nuk kanë turp që gënjejnë? Për çfarë u bë reforma në drejtësi? Këtu në këtë sallë ka deputetë që e kanë votuar këtë reformë, por kanë votuar për një drejtësi më të shpejtë, më afër qytetarit, profesionale dhe të paanshme. Ku është drejtësia më afër qytetarit dhe më e shpejtë, nga 180 ditë mesatarja në 730 ditë? Meqenëse i duan raportet e Europës, ejani t’i citojmë. Në raportprogresin e fundit ka shifra tronditëse, lërinin kremrat që hidhen përsipër. Duhet rreth 1742 ditë për një çështje civile apo administrative. Ky nuk është konstatimi im. Pra duhet rreth 5 vjet për të marrë drejtësi të zakonshme. Duhet 998 ditë për të marrë drejtësi për çështje të kriminalitetit, pra çështje penale, janë rreth 2 vjet e gjysmë – 3 vjet. Meqenëse duan Europën, vazhdojmë te Europa. Na dënon Strasburgu. Po për çfarë na dënon? Strasburgu na dënon për vonesa të pafundme, që i konsideron të pajustificuara, apo nuk ka rëndësi se çfarë thotë Strasburgu, rëndësi ka të lexojmë ndonjë gjë dhe të gënjejmë njerëzit. Harta e re gjyqësore, dakord, por t’ua shpjegojmë thjesht qytetarëve që na ndjekin. Çfarë është harta e re gjyqësore? Automatikisht në momentin që u bë kjo hartë, kjo mrekulli, u shtuan gjykatësit dhe prokurorët? 60% e tyre janë skartuar nga vetingu. Çfarë do të prodhojë? Do të prodhojë gjyqtarë më shumë? Do të prodhojë drejtësi për ta? Do ta marrin drejtësinë më shpejt? Do të jetë më profesionale? Nuk mund të jetë më profesionale, sepse nuk mund të gënjejnë veten. Këta mund të gënjejnë sa të duan, dhe është në të drejtën e tyre, por mesatarja e çështjeve të gjyqtarëve nga 200 ka shkuar në 2000. Çfarë profesionalizmi do të ketë në këtë punë? Ku është kjo drejtësi që ka avantazhet e saj në raport me qytetarin, i cili të jetë i lumtur pas 5 vjetëve e ca se po prek drejtësinë e re, po e prek me duar, po e

shikon se është më e mirë, më e re, më konkrete, më e qartë, po e ndihmon. Në vendime gjithmonë ka të pakënaqur, por marrin në kohë. A nuk ju vret ndërgjegjja që talleni dhe bëni demagogji që nga ai i pari, Kryeministri, i cili flet kodra pas bregut, sepse nuk i intereson për shqiptarët? Janë me mijëra, nuk po e ekzagjeroj, që po ikin nga kjo jetë dhe nuk u janë prekur dosjet me dorë. Janë rreth 36 mijë çështje në Gjykatën e Lartë dhe duartrokitet për drejtësi, për atë drejtësi që do të luftojë korrupsionin. Po, duartrokasin për institucionet e reja. Po cilat janë? SPAK-u, i cili kujdeset për kanalin kullues, për arkën e cironkave, por jo, më përpara flet Gjykata Kushtuese sesa flet SPAK-u për teatrin. Inceneratorët janë aty; janë gati dhe shumë punë është e bërë që të mos lodhen, por nuk e prek njeri. Është gjithë ajo aferë e madhe me miliardat e Portit të Durrësit, por ata nuk flasin asnjë fjalë. I kanë çështjet e krimeve zgjedhore të denoncuar me dokumente, por nuk flasin asgjë. Po, drejtësi e shkëlqyer! Drejtësi e shkëlqyer është vetëm për këta, pandëshkueshmëri absolute. Cironkat goditen egërsisht, kanali në Lushnje po, drutë e zjarrit në Pogradec po, vendime për ata që i kishin dhënë nga 10 mijë lekë ryshfet policisë po. Ku janë çështjet e mëdha që na shqetësojnë? Pra, është shumë e qartë që kjo nuk është drejtësia për qytetarët. Kjo është një fashë, të cilës është turp që i bëhet shërbim. Idenë kur thuhet: “Votoni vetingun, sepse a e dini se çfarë do të bëhet me vetingun?”, ta mbajnë për vete. Edhe vetingun me dy standarde ta shqyrtojnë më së miri, sepse ai veting prodhon gjyqtarë, të cilët kanë me qindra e miliona lekë, dhe rrinë në sistem, si Ardian Dvorani me shokë, ndërsa ca të tjerë, për hiç gjë, atje më tutje, me diçka të vogël konsiderohen si gjë e madhe dhe largohen nga sistemi. Këto janë të vërtetat, nuk janë të miat. Meqenëse duan konstatime joopozitare, Komiteti i Helsinkit dhe fondacioni “Soros” bëjnë sondazhe dhe thonë se 63% e qytetarëve nuk e besojnë vetingun. Çfarë do të thonë? Do të thonë se nuk e duam Helsinkin, sepse, kur kritikojnë, të gjithë dalin opozitarë. Pra, është e qartë që është një reformë në kolaps, sepse ka pasur vetëm një objektiv, të kapin me çdo kusht. Ka një “sukses” të reformës në drejtësi të padiskutueshme që është kapja. Kjo ka realizuar shkëlqyeshëm këtë objektiv që ka pasur edhe pandëshkueshmërinë absolute. Pra, në këtë mënyrë çdo lloj afere, sado e rëndë, do të bashkëjetojë e qetë dhe e paprekur. Meqenëse është dita që ne të bashkëbisedojmë me qytetarët, qytetarët janë më të zhgënjyer se kurrë më parë dhe, për fat keq, ca të tjerë po thonë fabulën negative, dhe ky është turpi i tyre: “Ishte më mirë kur ishte më keq”. Faleminderit!